

VENDIM
Nr. 19, datë 24.2.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datat 26.11.2025 dhe 24.2.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (Sh) 2025, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “Geci” sh.p.k., përfaqësuar nga avokatët Besim Hajdarmataj dhe Eritan Shehu, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4330 (460), datë 31.10.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për gjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueses, shoqërisë “Geci” sh.p.k. (*kërkuesja*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (*MIE*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “Geci” sh.p.k. (*kërkuesja*) është person juridik me objekt të veprimtarisë ndërtime civile dhe industriale, rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, rrugë, autostrada, mbikalime, linja tramvaji, metroje, hekurudhe me kavo, pista aeroportuale e të tjera. Për kategori të ndryshme të punimeve të ndërtimit kërkuesja është pajisur me licencën nr. NZ 1062/16, datë 4.10.2010, nga Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale (*Komisioni i Licencave*) në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit (*MPPT*).

2. Gjatë procedurës së prokurimit publik për ndërtimin e objektit rruga “Unaza e Re–Mullet Lot 1”, me shkresën nr. 5831/1, datë 22.10.2010, ministri i MPPT-së ka kërkuar nga Agjencia e Prokurimit Publik (*APP*) përjashtimin e kërkueses nga procedurat e prokurimit publik, duke u nisur nga faktet e administruara sipas dokumentacionit shkresor të depozituar pranë autoritetit

kontraktor, Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. APP-ja ka filluar procedimin administrativ për përjashtimin e kërkuases nga prokurimet publike.

3. Po ashtu, me shkresën nr. 5831/4, datë 12.11.2010, për shkak të gjetjeve dhe konstatimeve për deklaram të rremë në segmentin rrugor Dragobi-Valbonë, ministri i MPPT-së ka kërkuar nga Komisioni i Licencave nisjen e procedurave për dhënie mase administrative ndaj kërkuases. Në kuadër të kësaj procedure administrative, Komisioni i Licencave, me vendimin nr. 23, datë 15.11.2010 (*vendimi nr. 23/2010*), ka vendosur ndaj kërkuases masën administrative të heqjes të së drejtës së ushtrimit të aktivitetit për një kohë prej 3 vjetësh, për kategoritë: NP-4, rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale; NP-5, punime nëntokësore, ura e vepra arti; NS-9, punime strukturore speciale; NS-10, shtresa dhe mbistruktura speciale. Në vijim, me shkresën 17/11, datë 17.11.2010, Drejtoria e Licencimit pranë MPPT-së ka njoftuar kërkuesen për pezullimin e përkohshëm të kategorive të licencës, duke i bërë të ditur se licenca nr. NZ1062/16 është e pavlefshme dhe duke i kërkuar asaj dorëzimin e licencës dhe tërheqjen e licencës së re që reflektonte ndryshimet.

4. Pas lënies në fuqi të vendimit të Komisionit të Licencave nga ministri i MPPT-së, kërkuësja i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Licencave. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6526, datë 21.7.2011, ka vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. 23/2010 të Komisionit të Licencave. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2691, datë 13.12.2011, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-4000, datë 29.10.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur në gjykim.

5. Në datën 2.3.2011, kërkuësja ka marrë pjesë në disa procedura prokurimi të zhvilluara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) për rikonstruksion rrugësh. Në datën 4.4.2011, në publikimin e bërë në faqen e saj zyrtare, FSHZH-ja ka njoftuar për lidhjen e kontratave me operatorët e shpallur fitues në përfundim të këtyre procedurave të prokurimit. Në datat 5.4.2011 dhe 7.4.2011, me pretendimin se ka paraqitur ofertë ekonomike më të ulët sesa operatorët e shpallur fitues, kërkuësja i është drejtuar FSHZH-së, duke kërkuar arsyet se përse nuk është shpallur fituese dhe përse nuk është njoftuar për lidhjen e kontratës. Me shkresën nr. 182/1 prot., datë 11.4.2016, FSHZH-ja i ka kthyer përgjigje se për shkak të mosperformancës së saj dhe të çështjeve gjyqësore të pazgjidhura, Komiteti i Vlerësimit ka refuzuar ofertat e saj si të papërputhshme, duke konsideruar se ajo nuk ka përmbushur kriterin e kualifikimit.

6. Referuar procedurës së mësipërme, në datën 4.5.2016, kërkuësja i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e MPPT-së t'i paguajë dëmin jashtëkontraktor të shkaktuar në shumën 168.441.208 lekë, si rezultat i pezullimit të përkohshëm të licencës nr. NZ1062/16 në ushtrimin e aktivitetit në ndërtim, përveç edhe kamatat mbi këtë shumë nga data e ngritjes së padisë deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6076 (6117), datë 19.12.2016, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur, MPPT-së, të dëmshpërblente kërkuesen në shumën 168.441.208 lekë, duke i njohur edhe kamatat mbi këtë shumë në vlerën 570.807 lekë, si dhe një interes ditor në vlerën 4.292 lekë prej datës 5.9.2016 e në vijim. Sipas asaj gjykate, veprimet e së paditurës janë të kundërligjshme, pasi urdhrat për përjashtimin e kërkuases nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit janë dhënë pa filluar ende procedura administrative dhe pa pasur një vendim gjyqësor të formës së prerë, ndaj, nisur nga kjo, ajo duhet të shpërblente kërkuesen për dëmin jashtëkontraktor sipas përlllogaritjeve të bëra nga eksperti kontabël. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim MIE-ja dhe Avokatura e Shtetit.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2401, datë 12.9.2019, ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, duke rrëzuar padinë për sa i takonte kerkimit për pagimin e interesave në vlerën 570.807 lekë dhe të shumës 4.292 lekë për çdo ditë vonesë nga shpallja e vendimit, me arsyetimin se deri para ngritjes së

padisë, pala e paditur nuk ka qenë e detyruar të ekzekutonte ndonjë detyrim, duke mos qenë kështu ajo në vonesë për përmbushjen e tij. Nga ana tjetër, pretendimet në ankim lidhur me ekzistencën e dëmit jashtëkontraktor dhe masën e tij janë gjetur të pabazuara nga gjykata e apelit, duke konsideruar të drejtë analizën e fakteve dhe të ligjit nga gjykata e shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs MIE-ja dhe Avokatura e Shtetit, kurse kërkesja ka paraqitur kundërrekurs.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4330 (460), datë 31.10.2024, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë së kërkuës. Sipas Kolegjit Administrativ, referuar nenit 18, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), nenit 17, të ligjit nr. 8510, datë 15.7.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, të ndryshuar, si dhe nenit 115, shkronja “dh”, të Kodit Civil, ndryshe nga sa kanë arsyetuar gjykatat e faktit, padia e kërkuës është parashkruar, pasi është paraqitur tej afatit 3-vjeçar, i cili nuk ka filluar të ecë në datën 29.10.2015, kur është marrë vendimi i Kolegjit Administrativ që ka vendosur mospranimin e rekursit të MIE-së dhe Avokaturës së Shtetit, por nga data kur ka marrë formë të prerë vendimi për shfuqizimin e vendimit nr. 23/2010, të Komisionit të Licencave, pikërisht nga data 13.12.2011, kur është dhënë vendimi nr. 2691 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

9. Në datën 28.2.2025, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, në datën 13.5.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Me shkresën e datës 21.7.2025, palët janë njoftuar për zhvillimin e seancës plenare mbi bazë dokumenteve në datën 25.11.2025, kurse me shkresën e datës 20.11.2015, është njoftuar zhvillimi i seancës gjyqësore për në datën 26.11.2025.

10. Pas zhvillimit të seancës plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 26.11.2025, Gjykata ka deklaruar mbylljen e saj dhe tërheqjen e trupit gjykues për të marrë vendim. Gjykata e mbledhur në datën 11.12.2025 për vendimmarrjen e kësaj çështjeje, duke vlerësuar se ishte i nevojshëm sqarimi i rrethanave plotësuese me rëndësi për çështjen, bazuar në parashikimet e nenit 44, pika 1, të Ligjit Organik, ka vendosur riçeljen e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve, duke u kërkuar palëve paraqitjen e argumenteve me shkrim, përfshirë edhe të çdo prove relevante në drejtim të disa aspekteve konkrete të gjykimit kushtetues.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1 Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, për shkak të pjesëmarrjes në trupin gjykues në Gjykatën e Lartë të gjyqtarës E. M., relatores e çështjes, e cila duhej të kishte paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi pasi ndodhej në rrethana që e pengonin për të marrë pjesë në gjykim për shkak të njohjes familjare me përfaqësuesin ligjor të kërkuës R. G. (ortaku i vetëm dhe administratori i saj). Kjo gjyqtare, në kohën kur ushtronte detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka paraqitur heqjen dorë nga gjykimi i një çështjeje tjetër në të cilën kërkuësja ka qenë palë ndërgjyqëse, kërkesë që i është pranuar, ndërkohë që në rastin konkret ka mbajtur qëndrim të ndryshëm. Në kushtet kur raportet mes përfaqësuesit të kërkuës dhe gjyqtarës kanë ndryshuar gjatë viteve, duke pasur aktualisht një qasje konfliktuale mes tyre, pjesëmarrja e saj në gjykim ka ndikuar në dhënien e një vendimi të padrejtë që ka cenuar interesat e ligjshme të kërkuës, duke qenë në disfavorin e saj.

11.2 Së drejtës për t'u njoftuar, pasi kërkuesja nuk është njoftuar nga Gjykata e Lartë për zhvillimin e gjykimit sipas nenit 482, pika 3, të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, konkretisht, me anë të postës elektronike *email*-it, edhe pse kjo adresë ishte shënuar nga kërkuesja në kundërrekurs. Për këtë arsye ajo nuk ka marrë dijeni për përbërjen e trupit gjykues që do të gjykonte çështjen e saj, ndaj ka qenë në pamundësi për ta kundërshtuar atë nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për përjashtim të gjyqtarës E. M. Kërkuesja nuk ka marrë njoftim efektiv nëpërmjet shpalljes publike, pasi çështja e saj është regjistruar në Gjykatën e Lartë që në vitin 2019, duke pamundësuar objektivisht që ajo për një kohë të gjatë, më shumë se pesë vite, të kishte një vëmendje dhe mundësi objektive për të aksesuar, në mënyrë të pandërprerë dhe të përditësuar, çdo ditë ose javë njoftimet me shpallje në atë gjykatë. Për më tepër, kjo çështje pas regjistrimit të saj në vitin 2019 në Gjykatën e Lartë, duhet të jetë rishortuar me kalimin e viteve për shkak të ndryshimit të përbërjes së gjykatës, pasi rezulton se gjyqtarja relatores E. M. ka filluar ushtrimin e detyrës në atë gjykatë në vitin 2023.

12. **Subjekti i interesuar, MIE**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si në aspektin formal ashtu edhe substancial, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Një kriter tjetër ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 10, datë 13.3.2025; nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 15, datë 7.5.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në ankimin kushtetues individual kanë të bëjnë me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual (*shih vendimin nr. 24, datë 9.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, konsiderohet se kërkuesja ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion¹.

¹ Gjyqtari Ilir Toska votoi për mosplotësimin e këtij kriteri legjitimimi në lidhje me pretendimin e kërkueses për

17. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi objekt kërkese, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 31.10.2024, i cili, sipas akteve të dosjes gjyqësore i është njoftuar kërkueses nga ajo gjykatë përmes postës elektronike në datën 10.12.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 28.2.2025, pra brenda afatit 4-mujor.

18. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se për procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe asaj për t’u njoftuar për gjykimin. Në lidhje me këtë të fundit, kërkuesja ka pretenduar se nuk është njoftuar nga Gjykata e Lartë për zhvillimin e gjykimit sipas neneve 482, pika 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, përmes adresës elektronike të kontaktit (*email*), edhe pse ajo e kishte lënë këtë të dhënë në kundërrekursin e paraqitur në atë gjykatë. Sipas kërkueses, për këtë shkak ajo ka qenë në pamundësi për të kundërshtuar edhe përbërjen e trupit gjykues.

19. Gjykata, referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, vëren se në datën 27.9.2024, është publikuar lista e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit të datës 31.10.2024, ku bënte pjesë edhe çështja e kërkueses, si dhe përbërja e trupit gjykues, njoftim që, nga të dhënat e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton të jetë bërë edhe në ambientet e asaj gjykate. Po nga të dhënat e dosjes gjyqësore rezulton se në datën 27.9.2024, kërkuesja është njoftuar nga Gjykata e Lartë edhe në adresën e saj elektronike *email* për shqyrtimin e çështjes së saj në dhomën e këshillimit të datës 31.10.2024, si dhe për përbërjen e trupit gjykues, ku bënte pjesë edhe gjyqtarja E. M. Për shkak se kërkuesja ka pretenduar se ajo nuk ka marrë dijeni për datën e shqyrtimit të çështjes së saj në dhomën e këshillimit, për rrjedhojë as për përbërjen e trupit gjykues, në datën 11.12.2025 Gjykata kërkoi nga kërkuesja sqarimin e rrethanave plotësuese në këtë drejtim, me rëndësi për rastin konkret. Me shkresën e datës 22.12.2025, “Kthim përgjigje” kërkuesja ka sqaruar: *“Konstatimi juaj se në datën 27.9.2024 shoqëria “Geci” është njoftuar me email në adresën elektronike dhe pas verifikimit të postës elektronike rezulton të jetë i saktë dhe është e vërtetë se na është njoftuar me email përbërja e trupës gjyqësore e përbërë nga anëtarët E. M., A. V. dhe A. A., por nga ana e personit përgjegjës për kontrollin e postës elektronike, nuk jemi vënë në dijeni për këtë njoftim, prandaj dhe e kemi ngritur dhe pretendimin për mosnjoftimin e trupës gjykuese nga ana e Gjykatës së Lartë. Nga ana e Gjykatës së Lartë nuk na është njoftuar përbërja e trupës gjykuese në ndonjë formë tjetër njoftimi, përveç asaj me anë të postës elektronike.”*

20. Gjykata, bazuar në aktet e këtij gjykimi, konstaton se ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, Gjykata e Lartë i ka marrë të gjitha masat për njoftimin e datës dhe orës të gjykimit të çështjes së saj në përputhje me parashikimet e neneve 482, pika 3, të KPC-së dhe 61, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, duke e njoftuar atë edhe përmes postës elektronike në adresën e lënë në kundërrekurs. Në situatën që vetë kërkuesja ka pranuar faktin e ardhjes në adresën e lënë prej saj të *email*-it të dërguar nga administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë, pretendimi për mosmarrjen dijeni për gjykimin është haptazi i pabazuar. Nga ana tjetër, edhe nëse do të pranohej pretendimi i kërkueses për mosnjoftimin nga punonjësja e saj, mosmarrja dijeni nuk ka ardhur nga veprimet ose mosveprimet e Gjykatës së Lartë, pra për shkak të mosrespektimit

cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Në vlerësimin e këtij gjyqtari, Gjykata e Lartë, në kuptim të parashikimeve procedurale të zbatueshme, ka marrë të gjitha masat për njoftimin e kërkueses për datën dhe orën e gjykimit, por edhe për përbërjen e trupit gjykues. Ky njoftim asaj i është bërë jo vetëm përmes shpalljes publike dhe njoftimit në faqen e saj zyrtare, por edhe përmes postës elektronike (*email*), në adresën e lënë prej saj në kundërrekurs. Ky fakt, pra njoftimi elektronik, u pranua edhe nga vetë kërkuesja gjatë gjykimit kushtetues. Për rrjedhojë, kërkuesja është njoftuar rregullisht për përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë dhe për pjesëmarrjen në të edhe të gjyqtarës E. M. Në këto kushte, ndonëse ka pasur të gjitha mundësitë dhe mjetet ligjore për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarës në fjalë nga shqyrtimi i çështjes së saj në kuptim të neneve 72 dhe 74, të KPC-së, kërkuesja ka zgjedhur të mos e përdorë këtë mjet procedural, ndaj, për këtë arsye, në lidhje me këtë pretendim, ajo nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.

të rregullave të njoftimit nga kjo e fundit, por për shkak të mungesës së kujdesit të duhur të vetë kërkueses, e cila, nga ana tjetër, duke qenë edhe pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë përmes rekursit ka, gjithashtu, detyrimin që të ndjekë fatin e çështjes së saj.

21. Për sa i përket pretendimit tjetër të kërkueses në drejtim të *parimit të paanshmërisë në gjykim*, duke qenë me natyrë kushtetuese ai do të merret në vijim në shqyrtim në drejtim të bazueshmërisë së tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të paanshmërisë

22. Kërkuesja ka pretenduar se në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e saj në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë gjyqtarja E. M., e cila ka qenë edhe relatore e çështjes, edhe pse ndodhej në rrethana që pengonin pjesëmarrjen e saj në gjykim, për shkak të njohjes familjare me përfaqësuesin ligjor të kërkueses. Sipas kërkueses, kjo gjyqtare duhej të kishte hequr dorë nga gjykimi, qëndrim që ajo e ka mbajtur më parë në kohën kur ushtronte detyrën e gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku në një rast tjetër ka kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i një çështjeje të kërkueses për të njëjtin shkak, kërkesë që është pranuar. Kërkuesja ka pretenduar se në kushtet kur raportet e njohjes familjare kanë ndryshuar në drejtim të një qasjeje konfliktuale të diktuar nga rrethanat e kohës dhe raportet njerëzore gjatë viteve, pjesëmarrja në gjykim e gjyqtarës E. M. ka ndikuar ndjeshëm në një vendimmarrje të padrejtë që ka cenuar interesat e ligjshëm të kërkueses, për më tepër që vendimmarrja në këtë rast ka qenë në disfavorin e saj.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por edhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë se roli i tij gjatë gjykimit duhet të jetë pasiv dhe *super partes*. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar atë në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 56, datë 10.10.2025; nr. 4, datë 25.2.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, *testin subjektiv*, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, *testin objektiv*, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 10, datë 12.4.2022; nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata, nisur nga natyra e pretendimit të kërkueses, vlerëson se respektimi i parimit të paanshmërisë në gjykim duhet të shqyrtohet nga këndvështrimi i testit objektiv, pra nëse ekzistojnë fakte bindëse në lidhje me njëanshmërinë e gjyqtarës gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, duhet shqyrtuar nëse

shkaku i pretenduar i njohjes familjare të gjyqtarës E. M. me përfaqësuesin e kërkuësës është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim paanshmërinë e kësaj gjyqtareje, për rrjedhojë edhe vetë procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë nga pikëpamja kushtetuese.

26. Referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, si dhe akteve të dosjes gjyqësore të administruar, rezulton se çështja e kërkuësës është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 27.12.2019, mbi rekursin e palës së paditur në procesin gjyqësor. Pasi ka marrë dijeni për rekursin, kërkuësja ka paraqitur kundërrekurs në kundërshtim të pretendimeve të palës tjetër. Për shqyrtimin e kësaj çështjeje është caktuar relatore gjyqtarja E. M., e cila ka caktuar zhvillimin e seancës në datën 31.10.2024, duke kërkuar edhe marrjen e masave për njoftimin e saj palëve. Në datën 27.9.2024, administrata gjyqësore ka njoftuar shqyrtimin e çështjes së kërkuësës në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në datën 31.10.2024. Në këtë datë, pas shqyrtimit të rekursit të palës së paditur, Kolegji Administrativ, në përbërje të të cilit ka qenë edhe gjyqtarja E. M., ka vendosur përfundimisht ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe asaj administrative të apelit dhe rrëzimin e padisë së kërkuësës.

27. Gjykata konstaton se sipas nenit 72 të KPC-së, gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: *i.* ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; *ii.* ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; *iii.* ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; *iv.* ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetrës palë; *v.* është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim; *vi.* në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

28. Po kështu, rezulton se në datën 22.11.2010, kohë në të cilën gjyqtarja E. M. ushtronte detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ajo është shortuar për shqyrtimin e çështjes civile nr. 14818 akti, të regjistruar mbi padinë e kërkuësës kundër Drejtorisë së Licencimit pranë MPPT-së, Tiranë, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 23, datë 15.11.2010, të Komisionit të Licencave për pezullimin e përkohshëm të kategorive të licencës nr. NZ1062/16. Në datën 24.11.2010 gjyqtarja E. M., në mbështetje të nenit 73 të KPC-së, i ka paraqitur kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes, duke parashtruar si shkak njohjet familjare me paditësen (kërkuësen). Me vendimin e datës 25.11.2010, kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën e gjyqtarës E. M. për heqjen dorë nga gjykimi, bazuar në nenin 73 të KPC-së, duke urdhëruar rishortimin e çështjes për caktimin e një gjyqtari tjetër.

29. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në Gjykatën e Lartë, Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

30. *Sipas njërës qëndrim²* u vlerësua se shkaku për të cilin vihet në dyshim paanshmëria e gjyqtarës E. M. lidhet me ekzistencën e arsyeve serioze të njëanshmërisë për shkak të njohjes familjare të saj me ortakun e vetëm dhe administratorin e kërkuësës. Rezulton se për të njëjtin shkak kjo gjyqtare ka paraqitur më parë heqjen dorë, pa pritur që vetë pala të kërkojë një gjë të tillë, nga gjykimi i një çështjeje të kërkuësës në shkallë të parë, kërkesë që është pranuar, duke u konsideruar si një shkak që nuk lejonte pjesëmarrjen e saj në gjykim. Qëndrimi i mëparshëm

² Votuan për pranimin e kërkesës për këtë shkak gjyqtarët Sonila Bejtja, Genti Ibrahim, Marjana Semini dhe Sandër Beci.

i gjyqtares tregon se, në vlerësimin e asaj vetë, marrëdhënia mes saj dhe kërkueses ishte e tillë që mund të përbënte shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e saj në gjykim. Gjithashtu, rezulton se çështja objekt shqyrtimi në të cilën gjyqtarja E. M. ka qenë relatore në Gjykatën e Lartë është e lidhur me çështjen për të cilën ajo hoqi dorë nga gjykimi në shkallë të parë. Lidhja qëndron në faktin se ndërsa gjykimi në shkallë të parë kishte të bënte me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Licencave që kishte pezulluar licencën e kërkueses, gjykimi në Gjykatën e Lartë (objekt shqyrtimi) kishte të bënte me kërkimin e dëmit jashtëkontraktor, të shkaktuar pikërisht nga pezullimi i përkohshëm i licencës. Për më tepër, në rastin konkret gjyqtarja E. M. ka qenë edhe relatore e çështjes në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë cilësi, ka përgatitur aktet mbi të cilat është bazuar edhe diskutimi i çështjes në atë gjykatë. Nga ana tjetër, pa paragjykuar drejtësinë e vendimit, nuk mund të neglizhohet fakti se në përfundim të këtij gjykimi, bazuar edhe mbi relacionin dhe qëndrimin e gjyqtares relatore, situata e kërkueses është rënduar për sa kohë vendimet e gjykatave të faktit që kishin vendosur në favor të saj janë prishur duke u rrëzuar përfundimisht padia.

31. Në kontekstin e rrethanave të rastit konkret, pavarësisht faktit që kërkuesja nuk ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për përjashtimin e gjyqtares E. M. nga përbërja e trupit gjykues, mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi nga vetë gjyqtarja, pavarësisht se në prani të të njëjtit shkak mbi të cilin ajo kishte vepruar ndryshe në një çështje tjetër të kërkueses të lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, është e tillë që vë në dyshim paanshmërinë e saj, qoftë edhe në dukje. Duke qenë se parimi i paanshmërisë në aspektin objektiv dikton dhënien e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi prej saj (gjykatës) të çdo dyshimi në këtë drejtim, pjesëmarrja e gjyqtares E. M. në shqyrtimin e çështjes së kërkueses në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë lë vend për dyshime të arsyeshme në drejtim të paanshmërinë së saj në aspektin objektiv (aq më tepër po të mbahet parasysh fakti se ishte objektivisht e mundur shmangia e saj nga gjykimi). Në këto kushte, si dhe duke mbajtur parasysh standardet që vetë Gjykata zbaton në raste të tilla për gjyqtarët kushtetues (pavarësisht natyrës së ndryshme që ka gjykimi kushtetues në krahasim me gjykimin e zakonshëm), ky pretendim i kërkueses është i bazuar.

32. Sipas *qëndrimit tjetër*³, shkak i paraqitur nga kërkuesja nuk është fakt bindës për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtares relatore në Gjykatën e Lartë, ndaj vlen prezumimi i paanshësisë së saj. Konkretisht, kërkuesja ka parashtuar se gjyqtarja relatore ka njohje familjare me ortakun e vetëm (njëherazi administrator i kërkueses) dhe se kur ushtronte detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ajo ka hequr dorë nga gjykimi i një çështjeje të kërkueses, kërkesë e cila është pranuar nga kryetari i gjykatës. Sipas kërkueses, marrëdhëniet kanë ndryshuar dhe gjyqtarja ka aktualisht një qasje konfliktuale ndaj saj.

33. Nga analiza e kësaj rrethane, e ndërthurur me aktet e shqyrtuara gjatë gjykimit kushtetues, rezultojnë disa tregues të rëndësishëm, që hedhin dritë për zgjidhjen e pretendimit të kërkueses: i. vetë kërkuesja nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtares relatore nga trupi gjykues i Gjykatës së Lartë, ndonëse ka marrë njoftim rregullisht për përbërjen e trupit gjykues; ii. rrethana e njohjes familjare është e ndryshme nga ajo e armiqësisë, në kuptim të nenit 72, pika 3, të KPC-së, ndaj nga pikëpamja logjike paanshmëria e gjyqtares duhet të vihej në dyshim nga pala kundërshtare në gjykim e kërkueses dhe jo nga kjo e fundit; iii. rrethana e njohjes familjare është deklaruar në vitin 2010, kur ajo ushtronte detyrën e gjyqtares në shkallë të parë, pra përpara 14 vjetëve. Kjo periudhë kohore relativisht e gjatë nuk përjashton mundësinë e ndryshimit të marrëdhënieve midis gjyqtares dhe kërkueses, ndryshim të cilin duhet ta provonte vetë kërkuesja. Në këtë kuptim, kërkuesja nuk ka paraqitur asnjë fakt, ndaj deklarimi i thjeshtë i qasjes konfliktuale është i pamjaftueshëm; iv. pas vitit 2010, gjyqtarja relatore ka marrë pjesë në dhënien e disa vendimeve në gjykatën administrative të apelit, në proceset gjyqësore të vëna në lëvizje nga kërkuesja, duke votuar në favor ose kundër kërkueses.

³ Votuan për rrëzimin e kërkesës për këtë shkak gjyqtaret Fiona Papajorgji dhe Marsida Xhaferllari.

Kjo e fundit nuk rezulton ta ketë vënë në dyshim dhe për më tepër, pyetjes së Gjykatës për këto raste, ajo i është përgjigjur se “nuk na rezulton që kjo gjyqtare të ketë qenë pjesë e trupit gjykues te ndonjë gjykim tjetër ku ne kemi qenë palë ndërgjyqëse, e për rrjedhojë nuk rezulton të kemi bërë kërkesa për përjashtimin e saj”, duke iu shmangur thelbit të çështjes.

34. Për sa më lart, vlerësojmë se rrethana “*njohje familjare përpara 14 vjetëve*” nuk rrëzon prezumimin e paanshmërisë së gjyqtares dhe të trupit gjykues ku ajo ka marrë pjesë, duke mbetur në këtë mënyrë një dyshim objektivisht i pajustificueshëm. Për më tepër, pamjaftueshmëria e argumentit është e atillë për sa kohë kërkesja nuk ka paraqitur fakte ose prova bindëse të cilat vërtetojnë se qasja e ndikuar joobjektive e gjyqtares ka çuar në dhënien e vendimit në disfavor të saj. Sikurse Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj, procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrajnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (*shih vendimet nr. 57, datë 25.7.2017; nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 45, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*), rrjedhimisht argumentet e pamjaftueshme të kërkuësës bëjnë që pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për gjykim të paanshëm të jetë i pabazuar.

35. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuësës për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë konsiderohet e rrëzuar.

36. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar është haptazi i pabazuar, kurse pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë nuk mori shumicën e votave të kërkuara, për rrjedhojë kërkesa e saj rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4, dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.2.2026.

Shpallur më 2.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini